UDHËZIM
Nr.4363, datë 15.9.2011

PËR SHPENZIMET DHE KOSTON EKONOMIKE, PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE TË MBLEDHJES SË DETYRIMEVE NGA SUBJEKTET DEBITORE QË KANË PËRFITUAR NGA FONDI KUNDËRPARTI DHE NON PROJEKT GRAND AIDI, TË ARDHURA NGA GRANDET JAPONEZE, PËR SEKTORIN E BUJQËSISË E TË USHQIMT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, dhe të vendimit nr.868, datë 27.10.2010 "Për shpenzimet dhe koston ekonomike për zbatimin e procedurave për mbledhjen e detyrimeve nga subjektet debitore që kanë përfituar nga fondi kundërparti dhe "Non projekt Grand Aidi", të ardhura nga grandet japoneze për sektorin e bujqësisë e të ushqimit",

UDHËZOJMË:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Fondi gjendje prej 17.000.000 lekë të përdoret për mbulimin e shpenzimeve që do të kryhen gjatë procedurave për mbledhjen e detyrimeve nga subjektet debitore të financuara nga fondi kundërparti dhe "Non projekt Grand Aidi".

2. Fondi gjendje prej 17.000.000 lekë i mbledhur nga arkëtimi i detyrimeve nga furnizimi me karburant pa akcizë për mekanikën bujqësore, serrat me ngrohje dhe subjektet që kanë kaldaja në linjat e përpunimit të qumështit, i vitit 2006, duhet të derdhet pjesë-pjesë në Buxhetin e Shtetit në kapitullin VI të MBUMK (të ardhura jashtë limitit), në përputhje me nevojat që do të lindin për mbulimin e shpenzimeve (kostos) të mbledhjes së detyrimeve nga subjektet debitore.

3. Për subjektet debitore, të cilat nuk kanë paguar detyrimet kontraktuale, në mbështetje të kontratës së nënshkruar, kryhet sekuestrimi i mallrave, pajisjeve, linjave të përpunimit ose serrave me ngrohje.

4. Zhvillimi i procedurave të ankandit të kryhet në mbështetje të ligjit "Për ankandin publik" dhe i gjithë fondi i mbledhur nga shitja e tyre do të kalojë në llogari të fondit kundërparti dhe "Non projekt Grand-Aidit".

KREU II
AUTORITETI PËRGJEGJËS

1. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) është autoriteti përgjegjës për menaxhimin, organizimin, çmontimin, transportimin, ruajtjen e mallrave, pajisjeve, linjave të agropërpunimit apo serrës me ngrohje, në pronësi të AZHBR-së.

2. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural njofton me shkrim palën debitore që nuk ka përmbushur detyrimin sipas kushteve të kontratës së lidhur, duke i lënë atij një afat të përcaktuar prej 30 ditësh për fillimin e procedurave për marrjen e sendit.

3. Drejtori i Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural nxjerr urdhrin për kthimin e mallrave, pajisjeve, linjave të agropërpunimit apo serrës me ngrohje, në pronësi të AZHBR-së.

4. AZHBR planifikon punën për çmontimin e mallrave, pajisjeve, linjave të agropërpunimit apo serrës me ngrohje.

KREU III
PËRGATITJA E PROCEDURAVE

1. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, me miratimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, ngre komisionin e marrjes në dorëzim të sendeve, i përbërë nga 5 (pesë) përfaqësues, nga të cilët 4 (katër) nga AZHBR- ja, 1 (një) përfaqësues nga MBUMK.

2. Komisioni i marrjes në dorëzim të serrave me ngrohje dhe të linjave të përpunimit kryen

mbikëqyrjen e të gjithë procesit të çmontimit, transportimit, magazinimit dhe ruajtjes së sendeve sipas procedurave ligjore në fuqi.

3. Inventarizimi i sendeve do të kryhet nga përfaqësuesit e ngarkuar për kryerjen e këtij shërbimi. Një kopje e procesverbalit të inventarizimit të sendeve do t'u vihet në dispozicion edhe debitorëve.

4. Pas marrjes në dorëzim të sendeve, ato vlerësohen nga ekspertët përkatës të licencuar, të cilët përgatisin raportin mbi vlerësimin tekniko-ekonomik sipas standardeve ligjore.

5. Ekspertët e fushës parazgjidhen sipas ligjit me nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik".

KREU IV
VLERËSIMI I SENDEVE

1. Vlerësimi i mallrave, pajisjeve, linjave të përpunimit ose serrave me ngrohje, kryhet nga ekspertët e fushës duke u bazuar në standardet ligjore në fuqi.

2. Komisioni i marrjes në dorëzim dhe poseduesi i sendit/eve pas vlerësimit, firmosin procesverbalin e gjendjes fizike aktuale të sendit në momentin e marrjes në dorëzim. Procesverbali mbahet në 3 kopje origjinale.

KREU V
RUAJTJA, ÇMONTIMI, TRANSPORTIMI DHE MAGAZINIMI

1. Ruajtja e sendeve, serrave dhe linjave të përpunimit kryhet nga shërbimi i sigurisë së ruajtjes fizike të cilët përzgjidhen sipas procedurave ligjore në fuqi.

2. Subjekti debitor të cilit do t'i merret sendi, nuk duhet të ndryshojë, të dëmtojë apo të zhdukë asnjë pjesë apo aksesorë të objektit në ruajtje, në rast konstatimi ai do të mbajë përgjegjësi sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

3. Në rast se konstatohet mungesë apo ndryshim në sendet e inventarizuara, kjo përgjegjësi do të shtrihet edhe mbi personat që e kanë në posedim.

4. Në rastet kur konstatohet se sendet (serrat me ngrohje apo linjat e përpunimit) janë në proces pune, do të vendoset një afat i arsyeshëm ditësh nga cikli i plotë i përfundimit të përpunimit të prodhimit në proces.

5. Çmontimi i sendeve të kryhet pas inventarizimit dhe vlerësimit të tyre nga specialistët e ngarkuar.

6. Transportimi i mallrave do të kryhet nga mjete të specializuara të cilat do të përzgjidhen sipas procedurave të prokurimit.

7. Magazinimi i tyre do të kryhet në ambientet e zgjedhura për magazinimin e tyre sipas procedurave të prokurimit apo të marrjes me qira.

8. Pas magazinimit të tyre, të zhvillohen procedurat e ankandit sipas ligjit nr.9874, datë 14.2.2008, i ndryshuar me ligjin nr.10 346, datë 4.11.2010 "Për ankandin publik".

KREU VI
DISPOZITA E FUNDIT

1. Për zhvillimin e procedurave të mësipërme, ngarkohen përfaqësuesit e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si dhe përfaqësuesit e ngarkuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Për rastet e patrajtuara nga ky udhëzim, për shkak të faktorëve objektivë, me propozim të Drejtorit të AZHBR-së, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, përcakton mënyrën e zgjidhjes së këtyre rasteve me urdhër të veçantë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli
MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode